

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Karamuço: Vlorë Hyseni, dihej që në korrik që do shkarkohej - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/karamuco-vlore-hyseni-dihej-qe-ne-korrik-qe-do-shkarkohej/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:22:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 20:22:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c57d6df3391999589ca7bc89934a8434b3e55178f8b98cf3a9ebb9beb82d5a03
TEKSTI	4cf1252e457632e9340f60e2573d5370a3ab81515e9c50a544a3e7f36107a607
PAMJA	d4690a4e797018e6eadca3df6bba8943d4a55a69f5723a9529a495d5472c6acd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	08dc8948158dd45ec37ba149bf63a453e0b4004bcbbb2867a53d8881fd0d9b52
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/08dc8948158dd45ec37ba149bf63a453e0b4004bcbbb2867a53d8881fd0d9b52>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Donald Trump SHBA Asambleja e OKB Lufta në Ukrainë Sali Berisha

NOW ME ERLA MËHILLIN | PROGRAMS

Karamuço: Vlora Hyseni, dihej që në korrik që do shkarkohej



22 Shtator 2026 | 22:22

Eksperti i kriminalistikës, Ervin Karamuço, në një lidhje direkte me emisionin "Now" me Erla Mëhillin në Euronews Albania, është shprehur lidhur me arrestimin e Vlora Hysenit dhe marrëdhënies së Shërbimit Informativ të Shtetit me SPAK.

Karamuço tha se duhet të ishte vepruar me një taktikë ndryshe nga ana e SPAK lidhur me mënyrën se si Hyseni u procedua. Sipas tij, është e domosdoshme kryerja e një hetimi shterues për shkak të volumit që dosja e AKSH-it mbart.

"Pse duhet të ndajmë Vlora Hysenin nga SHISH. Është shumë e rëndësishme kjo. Nuk i inkriminon dot të gjithë punonjësit e SHISH. Unë e kam inkurajuar në këtë çështje dhe në çështjet e tjera edhe zotin Dumani, edhe zotin Maksuti të bëjnë një hetim shterues sepse dosja e AKSH-it është shumë e madhe dhe siç e tha dhe Eni ka shumë fraksione. Problemi është që në rastin konkret janë nxituar sepse duhet të kishin bërë një taktikë ndryshe sesi të ruanin shtetin duke kapur individë të veçantë që e kanë dëmtuar me veprimtarinë e tyre atë", tha Karamuço.

Ai gjithashtu shtoi se marrëdhënia midis dy institucioneve është e brishtë dhe një akt i tillë i kryer nga një individ i vetëm dëmton në mënyrë të drejtpërdrejtë SHISH-in.

Karamuço solli në vëmendje se shkarkimi i Vlora Hysenit ishte i pritshëm që në muajin korrik, duke e bërë situatën të parandalueshme.

"E përmendi prokurori, zoti Beci, që ka një marrëdhënie të ngushtë të vazhdueshme përditshme midis SHISH-it dhe SPAK-ut. Nuk mundet ti në një moment të përcaktuar të thuash nga bashkëpunëtorë hajde se do të arrestoj. Jo sepse dëmton veprimtarinë e komunitetit të inteligjencës dhe komunitetit ligjzbatues dhe të akuzës duhet ta bësh në mënyrë të diferencuar se janë disa balanca shumë të brishta. Aktet dhe veprimet që dëmtojnë institucionin, por janë kryer nga një individ. E kishin shumë të thjeshtë qoftë edhe kryeministri se ka që në korrik që thuhet do shkarkohet, madje po gjendej zëvendësuesi në korrik për zonjën Hyseni.

Në rastin e Vlora Hysenit unë mendoj se duhej shkarkuar fillimisht, të ishte kërkuar dorëheqja, të ishte larguar nga ai funksion, të mos shkonte me 80 drejtues të SHISH-it botëror në mbledhje aty të njoftohej akuza në Azerbajxhan, por të ishte në rrugë, qytetar i lirë dhe pastaj t'i viheshin prangat sepse kështu na inflikton një institucion të tërë që ne e kemi në krye të kupolës të sigurisë kombëtare", u shpreh ai.

LAJMI I FUNDIT

20:28 Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' te drogës Shpëtim Aliu

20:16 Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës

20:11 Trump zbulon marrëveshje aksionesh me vlerë miliona dollarë në industrinë e teknologjisë dhe AI

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

20:05 Shtetet Baltike i kërkojnë BE-së 500 milionë euro për mbrojtjen kundër dronëve

19:51 Moska refuzon armëpushimin, Lavrov: Rusia nuk do t'i ndalë luftimet

19:37 E ardhmja e Merz në pikëpyetje, gati gjysma e votuesve kërkojnë zgjedhje të reja

TESTIM

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

NOW ME ERLA MËHILLIN | PROGRAMS

Arrestimi i Vlora Hysenit: Mazhoranca nuk rrezikon pushtetin, e vetmja shpresë ndërkombëtarët

Gazetari Arjon Sulo ka qenë i ftuar këtë të martë në Now me Erla Mëhillin. Sulo ka komentuar arrestimin e Vlora Hysenit në kuadrin politik....

22:36 | 22/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | NOW ME ERLA MËHILLIN | VENDI

“Shpërndarja e informacioneve tek...”, Rexha zbulon arsyen e shkarkimit të Vlora Hysenit në Kosovë

Gazetari Xhemajl Rexha ka raportuar në “Now” se Vlora Hyseni, ish drejtoresha e SHISH si fillim ka qenë pjesë e Agjencisë Kosovare e Inteligjencës që...

22:27 | 22/09/2026

NOW ME ERLA MËHILLIN | PROGRAMS

Karamuço: SPAK u nxitua me Vlora Hysenin, duhet të ruhej shteti! Ja arsyeja

Eksperti i sigurisë Ervin Karamuço ka folur këtë të martë në Now me Erla Mëhillin për masën e sigurisë ndaj drejtueses së SHISH, Vlora Hyseni....

22:16 | 22/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms: